




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



PËR: Drilon Hoxha, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë

NGA: Muhamet Rexha, Kryetar i Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore

LËNDA: Përgjigje

DATA: 28.03.2024

I nderuar gjyqtar Hoxha,

Komiteti Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore, (me tutje si “KKEGJ”), me datë 25 mars 2024 përmes postes elektronike ka pranuar nga ju pyetje me të cilën keni kërkuar që të jepet opinion se a keni të drejtë si gjyqtar të pranoni subvencione (mbështetje) nga Qeveria në një vlerë të caktuar në të holla, nëse këtë të drejtë e keni fituar para dekretimit por të hollat si mbështetje i merreni pas dekretimit dhe nëse këtë të drejtë e keni fituar pas dekretimit.

Bazuar në nenin 1, 7, paragrafi 1, dhe 9, të Rregullores Nr.01/2022, për Themelimin e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore, KKEGJ ka shqyrtuar kërkesën tuaj në takimin e mbajtur me datë 27 mars 2024.

Pas shqyrtimit të kërkesës suaj, KKEGJ ka ardhur në përfundim se lidhur me çështjen e ngritur nga ana juaj nuk është e nevojshme të nxjerrët opinion këshillëdhënës, pasi që bazuar ne nenin 1, paragrafi 4, të Rregullores Nr.01/2022 për Themelimin e Komitetit të Etikës Gjyqësore, është përcaktuar qartë se opinionet e Komitetit jepen lidhur me situatat apo sjelljet e ardhshme të cilat mund të konsiderohen në kundërshtim me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë, për dallim nga procesi disiplinor ku përfshihen hetime dhe seancat e mundshme që shqyrtojnë dhe zgjidhin ankesa për sjelljet e pretenduara jo etike të gjyqtareve në të kaluarën.

Komiteti ka vlerësuar se pyetjet e paraqitura nga ju kanë të bëjnë me një situatë që veç se ka ndodhur, prandaj Komiteti nuk mund të vlerësoj situatën që tani më ka ndodhur.

Sidoqoftë, KKEGJ e vlerëson lartë kontributin tuaj profesional për çështjet e ngritura, si dhe ju inkurajon juve dhe gjyqtarët e tjerë që për të gjitha dilemat rreth shkeljeve të mundshme, ti drejtoheni Komitetit.

Me respekt,